

Fillon realizimi i hulumtimit: Vlerësimi i faktorëve të rrezikut për sëmundje kronike në Kosovë – STEPS

Prishtinë, 2 prill 2019

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, bazuar në vendimin e Ministrit të Shëndetësisë, ka filluar filluar realizimin e hulumtimit për vlerësimin e faktorëve të rrezikut për sëmundje kronike në Kosovë – STEPS mbikëqyrja.

Qëllimi i STEPS hulumtimit është që të përcaktojë shpërndarjen e faktorëve të rrezikut për sëmundje kronike në Kosovë në mesin e popullatës së moshës 18 deri 69 vjet, dhe në këtë mënyrë të kontribuoj në rekomandimet e politikave dhe programeve në shëndetësinë publike.

Ky studim do të përcaktojë shkallën e disa prej faktorëve kryesorë të rrezikut për Sëmundjet Kronike Jo-ngjithëse në Kosovë si: Përdorimi i duhanit; Konsumimi i alkoolit; Përdorimi i pakët i frutave dhe perimeve; Përdorimi i lartë i kripës në dietë; Mos-aktiviteti fizik; Shtypja e rritur e gjakut; Obeziteti; Rritja e glikemisë esull dhe niveli i lartë i yndyrnave në gjak.

IKSHKP do të grumbullojmë informacion prej 3072 pjesëmarrësve nga tërë Kosova në vendbanimet në të cilat hulumtimi do të realizohet gjatë tre hapave.

Reduktimi i faktorëve të rrezikut për shëndetin ka qenë preokupim i njerëzve, mjekëve dhe politikanëve gjatë historisë. Sëmundjet kronike jo-ngjithëse vazhdojnë të

dominojnë në mbarë botën. Ato janë përgjegjëse për shumicën e vdekjeve në nivel global. Gjithsej 56 milionë vdekje në mbarë botën janë shkaktuar në vitin 2012.

Prej këtyre, 38 milionë (68%) ishin nga sëmundjet kronike jo-ngjitëse, veçanërisht sëmundjet kardiovaskulare, kanceri dhe sëmundjet kronike respiratore. Më 2030, këto shifra pritet të rriten në 52 milionë vdekje. Përafërsisht 42% e vdekjeve nga sëmundjet kronike jo-ngjitëse janë premature dhe shkaktohen para moshës 70 vjeçare.

Ndryshueshmëritë në duhan-pirje, shtypje të gjakut, dhe obesiteti shpjegojnë ndryshueshmëritë në mortalitetin prej sëmundjeve kardiovaskulare dhe kancerit si dhe jetëgjatësinë e pritur të jetës.

Ky hulumtim realizohet me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë-Zyra në Prishtinë dhe nga SDC-Swiss Agency for Development and Cooperation (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim).



